



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

---

Numri i lëndës: 2023:209680

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05128523

**PPP. nr. 56/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit SH.A (K...), kundër debitorit S.R nga Gllogoci, lidhur me lirimin e pronës-banesës, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit F.B, P.nr... të datës 18.08.2023, jashtë seancës me datën 27.12.2023 e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** prapësimi i debitorit S.R, nga Gllogoci, i datës 28.09.2023 i paraqitur kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat F.B nën shenjën P. nr... i datës 18.08.2023, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit SH.A (K...), për përmbartimin dhe lirimin e pronës-banesës në objektin nr... në Gllogoc në bërë të dokumentit të përmbartueshëm-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc nën shenjën C.nr... i datës 14.10.2019, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat, P. nr... i datës 18.08.2023 **mbetet në fuqi**.

**A r s y e t i m**

Kreditori SH.A (K...) ka parashtruar propozim tek Përmbartuesi Privat F.B nga Gllogoci për lejimin e përmbartimit në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc C.nr... i datës 14.10.2019 i plotëfuqishëm prej datës 02.03.2023 dhe i ekzekutueshëm prej datës 13.04.2023, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac. nr. 5858/19 datës 03.03.2023 lidhur me lirimin e pronës-banesës që gjendet në Gllogoc, Objekti nr..., si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbartuesi Privat F.B, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc C.nr.150/15 i datës 14.10.2019 i plotëfuqishëm prej datës 02.03.2023 dhe i ekzekutueshëm prej datës 13.04.2023, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.5858/19 i datës 03.03.2023.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor për shkak të shkeljes thelbësorë të dispozitave të LPP-së, Vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se *“Debitori ka investuar në këtë banesë në shumën prej 20 mijë Euro, dhe se kjo banesë nuk është objekt në qarkullim juridik dhe se e njëjta nuk është pranuar teknikisht dhe nuk ka leje të përdorimit”*. Andaj, ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 1 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P.nr... i datës 18.08.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimin të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të përmbarueshëm-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc C.nr.150/15 i datës 14.10.2019 i plotëfuqishëm prej datës 02.03.2023 dhe i ekzekutueshëm prej datës 13.04.2023, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.5858/19 i datës 03.03.2023 të lartëcekura, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto ekstrakte si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmbar dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të nenit 21, 22, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimin janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të përmbarueshëm nga të cilat shihet se debitori ka detyrim të përmbushë aktgjykimin e lartëcekur si në dispozitiv të tij.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim të ia lirojë pronën Kreditorit pasi dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, se ai ka investuar në këtë banesë në shumën prej 20 mijë Euro, se kjo banesë nuk është objekt në qarkullim juridik, e njëjta nuk është pranuar teknikisht dhe nuk ka leje të përdorimit. Gjykata këto pretendime të debitorit nuk i aprovoj sepse janë në kundërshtim me dispozitivin e dokumentit të përmbarueshëm si më poshtë, ndërsa kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur dokumentin e përmbarueshëm që është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc nën shenjën C.nr.150/15 i datës 14.10.2019 i plotëfuqishëm prej datës 02.03.2023 dhe i ekzekutueshëm prej datës 13.04.2023, i cili Aktgjykim i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbarueshëm në kuptim të Nenit 22 të LPP-së par. 1 nën-par. 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se *“Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i gjykatës, dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarues”*.

Aktgjykimi në fjalë në pjesën lartë në anën e majtë në faqen e parë përmbar vulën katrore të formës së prerë të datës 02.03.2023, dhe në fund të tij në faqen e pestë përmbar vulën katrore të ekzekutueshmërisë të datës 13.04.2023. Rrjedhimisht, i njëjti është i formës së prerë dhe i

ekzekutueshëm/përmbareshëm, dhe me të njëjtin ka përfunduar procedura kontestimore në fazën që nuk ndalon ekzekutueshmërinë.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbaresh për caktimin e përmbareshimit P.nr... të datës 18.08.2023, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc**  
**Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 56/23, datë 27.12.2023**

**G j y q t a r i**

**Astrit Gashi**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbareshimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.